



Periodik mujor Nr. 171 Gusht 2023

**Në
këtë
periodik
do të lexoni:**

**Publikohet
«Gjeografia e Sigurimeve 2022»**

**VËSHTRIM
MBI TREGJET**

Tregu i Sigurimeve, Janar- Korrik 2023

3

ZHVILLIME TË TJERA

**BOTIME
PROFESIONALE**

4 - 10

**INFORMACIONE
NDËRKOMBËTARE**

11-13

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar – Korrik 2023


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për muajin janar-korrik 2023 kapën vlerën 13,198 milionë lekë, ose 11.22% më shumë se në janar-korrik 2022. Gjatë muajit janar-korrik 2023, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 794,312 me një rritje prej 12.58% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.02% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, sigurimet e Jetës kanë 7.90% dhe risigurimi 0.08%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 42.92% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 57.08% të totalit të tregut.

Gjatë muajit janar-korrik 2023, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 3,919 milionë lekë, ose 5.43% më shumë se në muajin janar-korrik 2022.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin e motorik për muajin janar-korrik 2023 kapën vlerën 2,829 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 12.25% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Struktura e tregut të sigurimeve, Janar – Korrik 2023 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar-gusht 2023 arritën rreth 7,533 milionë lekë, ose 7.81% më shumë se në periudhën janar-korrik 2022.

ZHVILLIME TË TJERA

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare publikon “Gjeografia e Sigurimeve 2022”



“Gjeografia e Sigurimeve 2022”, pasqyron në mënyrë të detajuar shpërndarjen e primeve të shkruara bruto, dëmeve të paguara si edhe primit për frymë, sipas prefekturave.

Duke analizuar shpërndarjen gjeografike të primit të shkruar bruto, vërehet një përqendrim i tregut të sigurimeve në prefekturat e mëdha, si Tirana me 62.87% të totalit të primeve të shkruara bruto gjatë vitit 2022, Durrësi me 7.36%, Fieri 4.69%, Elbasani 4.39% dhe Korça 4.32%. Kjo tendencë përqendrimi ka vijuar e tillë për një periudhë 15-vjeçare.

Një tregues tjetër i rëndësishëm i tregut të sigurimeve është dendësia e sigurimeve. Për vitin 2022 ky tregues është rreth 7,598 lekë për frymë, me një rritje rreth 711 lekë krahasuar me një vit më parë.

Përsa i përket primit për frymë sipas prefekturave, prefektura Tiranë me 14,258 lekë për frymë zë vendin e parë, e pasuar nga prefektura Gjirokastrë me 7,065 lekë për frymë dhe më tej Durrësi me 5,333 lekë për frymë, Vlora me 4,725 lekë për frymë dhe Korçë me 4,698 lekë për frymë.

Ky publikim përfshin gjithashtu edhe informacion të hollësishëm për dëmet e paguara gjatë vitit 2022 sipas prefekturave, duke krijuar edhe mundësinë e krahasimit të këtyre treguesve me ato të një viti më parë. Përsëri pjesën më të madhe të dëmeve të paguara e ka prefektura e Tiranës me 70.28%, e pasuar nga prefektura Durrësi me 7.34%.

Gjeografia e Sigurimeve 2022 gjendet në faqen zyrtare të Autoritetit, në linkun: https://amf.gov.al/statistik_a.asp?id=4

EIOPA publikon për konsultim një material studimor për hendekun në mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe mundësinë e mbulimit me sigurim NatCat.



EIOPA ka hapur konsultimet mbi një material studimor të përgatitur nga stafi i saj për hendekun në mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe mundësinë e mbulimit me sigurim NatCat. Konsultimet janë hapur në fillim të korrikut dhe mbyllen në fillim të tetorit 2023. Ashpërsia dhe intensiteti i ngjarjeve të lidhura me klimën kanë sjellë rritjen e fokusit të EIOPA në adresimin e boshllëqeve në mbrojtjen nga këto ngjarje të klimës. EIOPA ka ndërmarrë një sërë iniciativash që synojnë të sigurojë që sektori i sigurimeve të jetë elastik, t'i bëjë ballë goditjeve klimatike dhe të kontribuojë në qëndrueshmërinë e shoqërisë ndaj goditjeve të tilla.

Përmbledhja ekzekutive

Duke pasur parasysh rritjen e ashpërsisë dhe intensitetin e ngjarjeve të lidhura me klimën dhe si pjesë e strategjisë së BE-së për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, EIOPA ka rritur fokusin e saj në adresimin e boshllëqeve të mbrojtjes nga këto ngjarje të natyrës. EIOPA ka ndërmarrë një sërë iniciativash që synojnë të sigurojë që sektori i sigurimeve të jetë mjaft elastik për t'i bërë ballë goditjeve klimatike dhe që ai të kontribuojë në bërjen e shoqërisë më elastike ndaj goditjeve të tilla.

EIOPA ka kryer dy studime që synojnë të kuptojnë pengesat nga ana e kërkesës, nxitësit dhe zgjidhjet e mundshme për hendekun e mbrojtjes nga katastrofa natyrore, NatCat. Përveç nismave ekzistuese, me këtë material studimor, EIOPA hulumton shkaqet themelore të hendekut të mbrojtjes së sigurimit NatCat nga këndvështrimi i kërkesës dhe thekson mundësitë për të adresuar kryesisht faktorët e kërkesës.

Vijon ...

EIOPA publikon për konsultim një material studimor për hendekun në mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe mundësinë e mbulimit me sigurim NatCat.

... Vijon

Në përgjithësi, mbulimi i NatCat në Evropë mbetet i ulët për një sërë arsyesh. Në fakt, vetëm disa shtete anëtare kanë mbulim të detyrueshëm ose ofertë të detyrueshme të mbulimit. Marrja e ulët e mbulimit NatCat lidhet me një sërë faktorësh nga ana e kërkesës, të cilët janë identifikuar si një pengesë për marrjen e produkteve të sigurimit NatCat, edhe kur produktet janë të disponueshme në treg:

- **Të ardhurat, kushtet financiare ekzistuese dhe fokusi tek primi janë një pengesë e rëndësishme në marrjen e këtij sigurimi.** Primi është shpesh faktori më i rëndësishëm për shumë konsumatorë në procesin e vendimmarrjes për këtë sigurim, duke i shtyrë ata ta perceptojnë sigurimin si të shtrenjtë dhe/ose të papërbalueshëm. Primit shpesh perceptohen si shumë të larta edhe në rastet kur kanë vlerë dhe dobi. Kjo për faktin se gjatë blerjeve, konsumatorët shpesh nuk këshillohen apo udhëzohen të shikojnë gjithëpërfshirjen e mbulimit dhe nga ana tjetër vetë konsumatorët nuk bëjnë një vlerësim të plotë për vlerën e produktit dhe dobinë e tij. Për më tepër, të ardhurat ndikojnë edhe në kushtet e strehimit të konsumatorëve, ku disa lloje banesash ndoshta nuk janë të sigurueshme ose janë të tilla vetëm me një kosto të lartë.
- **Mungesa e qartësisë për sa i përket kostove dhe mbulimit, si dhe kuptimi i kufizuar se si funksionon sigurimi, luajnë një rol të rëndësishëm.** Ndërsa shumë konsumatorë argumentojnë se nuk mund të përballojnë sigurimin NatCat, disa i perceptojnë primit si shumë të larta për shkak të qartësisë së kufizuar në kosto dhe mbulim, duke e bërë të vështirë vlerësimin e dobisë së produktit. Perceptimi i gabuar për mundësinë e përballimit lidhet gjithashtu me njohuritë e kufizuara, apo të pamjaftueshme financiare, ose edhe me kompleksitetin e produktit. Konsumatorët e kanë të vështirë dhe shpesh vendosin të mos blejnë sigurime, sepse zgjedhja e policës optimale është një punë që kërkon kohe dhe përpjekje.
- **Përvojat e mëparshme (negative), vetjake ose të njerëzve që i rrethojnë, mund të jenë gjithashtu një pengesë e rëndësishme për marrjen e sigurimit NatCat.** Një nga dy studimet e kryera nga EIOPA tregoi se vetëm gjysma e të anketuarve besonin se kompanitë e sigurimeve do të paguanin për humbjet e NatCat dhe kjo nga ana tjetër ndikon në gatishmërinë e tyre për të blerë produktin e sigurimit. Përvojat e të tjerëve dhe perceptimi i përgjithshëm i sigurimit mund të jenë gjithashtu një pengesë e rëndësishme.

Vijon ...


Materiali gjendet në linkun:

<https://www.eiopa.europa.eu/consultations/consultation-staff-paper-measures-address-demand-side-aspects-natcat-protection-gap/en>

EIOPA publikon për konsultim një material studimor për hendekun në mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe mundësinë e mbulimit me sigurim NatCat.

... Vijon

- EIOPA evidentoi më tej se ata konsumatorë të cilët kanë parë raste kur siguruesit paguanin shpejt shumicën e dëmit, janë më shumë të prirur për të blerë sigurime. Përkundrazi, nëse mungesa e përgjithshme e besimit mbizotëron në perceptimin e komunitetit, për shkak të përvojës së mëparshme të keqe, kjo ngre dyshime për mbulimin aktual të ofruar.
- **Konsumatorët, në shumë shtete anëtare, nuk blejnë mbulim edhe sepse nuk janë të vetëdijshëm për rreziqet, ose i perceptojnë keq rreziqet ndaj të cilave ata janë të ekspozuar.** Një nga studimet e EIOPA-s tregoi se mesatarisht mbi 30% e të anketuarve deklaruan se arsyeja kryesore për të mos qenë të siguruar ishte se ata i konsideronin ngjarjet e NatCat si shumë të pamundura. Mungesa e përvojës së mëparshme me ngjarjet NatCat zvogëlon perceptimin e rrezikut, duke ndikuar në marrjen e mbulimit. Individët priren të ndërtojnë perceptimin e tyre për rrezikun, bazuar në vendndodhjen e tyre ose në përvojat e tyre me ngjarjet e NatCat, ku përqindja e të anketuarve që ishin të siguruar është dy herë më e madhe mes atyre që kanë përjetuar një ngjarje NatCat, sesa midis të anketuarve që nuk e kanë pasur një përvojë të tillë.
- **Pritshmëritë e larta për ndërhyrjen e shtetit, ulin gjithashtu gatishmërinë e konsumatorëve për të blerë këtë mbulim sigurimesh.** Një nga studimet e EIOPA-s tregon se në shtetet anëtare me përfshirje më të ulët, ndërhyrja e shtetit perceptohet si pothuajse e sigurt, ndërsa në realitet kjo mund të mos materializohet plotësisht. Rezultatet e sondazhit tjetër të EIOPA-s tjetër tregojnë se 59% e të anketuarve gjithashtu treguan se qeveritë duhet të jenë përgjegjëse kur njerëzit përjetojnë humbje për shkak të ngjarjeve NatCat.
- **Së fundi, mënyra në të cilën shiten NatCat dhe sigurimet e shtëpive, në shumë tregje, kontribuon në marrjen e ulët të produkteve NatCat.** Shumica e marrjes në sigurim të shtëpive, i cili është mekanizmi kryesor për marrjen e sigurimit NatCat, është e lidhur me procesin e marrjes së një kredie hipotekore, duke e bërë blerjen e mbulimit NatCat më pak të mundshme për ata që nuk zotërojnë një shtëpi dhe/ose kanë fituar pronësinë me mjete të ndryshme. Kjo bën që sigurimi i shtëpisë të perceptohet si një detyrim dhe jo si një përfitim. Për më tepër, në shumë shtete anëtare, konsumatorët e perceptojnë procesin e blerjes së sigurimit të shtëpisë si të vështirë dhe kjo vepron si një pengesë e rëndësishme.

Vijon ...

Materiali gjendet në linkun:

https://www.eiopa.europa.eu/consultations/consultation-staff-paper-measures-address-demand-side-aspects-natcat-protection-gap_en

EIOPA publikon për konsultim një material studimor të saj për hendekun në mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe mundësinë e mbulimit me sigurim NatCat.

... Vijon

Bazuar në nxitësit dhe në barrierat e identifikuar, të cilat formësojnë vendimet e konsumatorëve në lidhje me blerjen e mbulimit NatCat, u testuan zgjidhje të ndryshme. Kjo tregoi se sigurimi mund të rritet pas një sërë ndërhyrjesh ekskluzive dhe përforcuese dhe informuese. Kur shqyrtohen si nxitësit, ashtu edhe pengesat për të marrë në sigurim, nga njëra anë, ashtu edhe zgjidhjet e mundshme, nga na tjetër, është e rëndësishme të kihet parasysh se tregjet e sigurimeve në të gjithë Evropën janë të ndryshme, dhe në veçanti ekzistojnë lloje të ndryshme të skemave të mbrojtjes NatCat.

Rritja e ndërgjegjësimit për rrezikun dhe mundësinë e mbulimit mund të nxisë marrjen e mëtejshme në sigurim, veçanërisht nëse bëhet nëpërmjet mjeteve specifike të përshtatshme dhe shpjeguese. Zhvillimi i mjeteve të aksesueshme, që u ofrojnë konsumatorëve informacion të dorës së parë mbi rrezikun me të cilin përballen, mund të jetë i dobishëm në rritjen e marrjes në sigurim. Përkatësisht, faqet e internetit publike dhe/ose të pavarura u mundësojnë konsumatorëve të konsultohen me nivelin e rrezikut të rajoneve të tyre, shtëpisë së tyre dhe e lehtësojnë konsumatorin të kuptojë më mirë rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar prona e tyre. Mesazhet e drejtuara mbi rreziqet ndaj të cilave konsumatorët janë të ekspozuar dhe disponueshmëria e mbulimit, përfshirë para marrjes me qira të një shtëpie ose blerjes së një prone, mund të rrisë ndjeshëm marrjen.

- **Rritja e marrjes në sigurim për NatCat, mund të vijë edhe nga rritja e të kuptuarit të konsumatorëve, krahasueshmërisë së produktit dhe promovimi i thjeshtësisë duke përfshirë produktin e përshtatshëm, mbikëqyrjen dhe qeverisjen - pa penguar ofertën e produkteve më të sofistikuar për ato tregje të synuara që e kërkojnë atë.** Konsumatorët mund të jenë më të gatshëm të blejnë produkte NatCat nëse disponohen mjete krahasimi të pavarura dhe të lehta për t'u përdorur. Në veçanti, mjete të tilla duhet të ndihmojnë njerëzit, në krahasimin e të gjitha produkteve të disponueshme të sigurimit me mbulimin për NatCat, me kritere të përmirësuara krahasimi përveç çmimit, duke siguruar që produktet të mbeten të krahasueshme. Përtej mjeteve të thjeshta të krahasimit, një nga studimet e EIOPA-s tregoi se konsumatorët do të ishin më të gatshëm të eksploronin blerjen e mbulimit të NatCat nëse produktet do të ishin më të thjeshta, d.m.th. nëse nevojat dhe karakteristikat e konsumatorëve, duke përfshirë të kuptuarit e tyre për produktet do të merreshin mirë parasysh në fazën e ndërtimit/krijimit të produktit. Mesatarisht, konsumatorët theksuan se do të ndiheshin më rehat në blerjen e mbulimit NatCat nëse do të ishin në dispozicion produkte të standardizuara (mbulimi, përjashtimet dhe praktikrat e çmimeve).



Materiali gjendet në linkun:

https://www.eiopa.europa.eu/consultations/consultation-staff-paper-measures-address-demand-side-aspects-natcat-protection-gap_en



Vijon ...

EIOPA publikon për konsultim një material studimor të saj për hendekun në mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe mundësinë e mbulimit me sigurim NatCat.

... Vijon

- **Promovimi i thjeshtësisë në marrjen e sigurimit mund të rrisë gjithashtu marrjen e produkteve NatCat, veçanërisht për ata konsumatorë që tashmë janë të vetëdijshëm si për disponueshmërinë e mbulimit, edhe për rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar.** Zhvillimi i qasjeve më miqësore ndaj konsumatorit, me më pak pika kontakti në procesin e blerjes, duke përdorur mjetet digjitale, mund të zvogëlojë përpjekjet e konsumatorëve në procesin e blerjes dhe, për rrjedhojë, të çojë në uljen e kostove të përgjithshme të transaksionit. Për të shmangur çështjet që lidhen me një mospërputhje midis pritshmërive dhe mbulimit aktual, hartuesit e produkteve të sigurimeve dhe shpërndarësit e sigurimeve duhet gjithashtu të sigurojnë që ata ofrojnë informacion adekuat dhe të detajuar mbi mbulimin NatCat, duke përfshirë përjashtimet dhe kufijtë e mbulimit.
- **Reduktimi i primit nëpërmjet detyrimeve për të vendosur masa për zbutjen e rrezikut, jo vetëm që mund të kufizojë ekspozimin e siguruesve ndaj rreziqeve, por edhe të stimulojë konsumatorët për marrjen e mbulimit NatCat.** Konsumatorët mund të jenë më të gatshëm të blejnë mbulimin NatCat nëse u ofrohen stimuj për të investuar në masat për zbutjen e rrezikut. Kjo masë do të lehtësonte gjithashtu paragjykimet kosto-përfitim dhe perceptimin e sigurimit NatCat si një "i këndshëm për t'u pasur" dhe jo një "duhet ta kemi". Nëse konsumatorëve do t'u ofroreshin zbritje e primit për marrjen e masave për zbutjen e rrezikut, ata do të ishin gjithashtu më të gatshëm të blinin mbulimin NatCat dhe të vendosnin masa për zbutjen e rrezikut, krahas përpjekjeve të shtuara për të komunikuar siç duhet në lidhje me masat ekzistuese të zbutjes së rrezikut.

Ky material studimor synon të plotësojë punën e EIOPA-s për adresimin e hendekut të mbrojtjes NatCat. EIOPA mirëpret komentet nga aktorë të ndryshëm, deri më 05 tetor 2023, mbi:


- (i) Rreziqet kryesore;
- (ii) Nxitësit e identifikuar që mund të kufizojnë marrjen e mbulimit NatCat; dhe
- (iii) Zgjidhjet e mundshme.

Bazuar në reagimet e marra, EIOPA do të nxjerrë një dokument të rishikuar të stafit të saj dhe do të shqyrtojë më tej zbatimin e një ose më shumë prej zgjidhjeve të propozuara.

Materiali gjendet në linkun:

https://www.eiopa.europa.eu/consultations/consultation-staff-paper-measures-address-demand-side-aspects-natcat-protection-gap_en

OECD publikon “Pension Market in Focus”



OECD publikon “Pension Market in Focus” – një vështrim i fokusuar në tregun e pensioneve dhe te dhënat e tij për vitin 2022. Ky publikim është një raport vjetor i cili mbulon informacionet nga 87 vende dhe jep një pasqyrë të përgjithshme të sistemit të pensioneve duke nënvizuar zhvillimet më të fundit.

Materiali i publikuar
gjendet në linkun:

<https://www.oecd.org/finance/private-pensions/pensionmarketsinfocus.htm>

Publikimi “Tregjet e pensioneve në fokus – Të dhënat paraprake për vitin 2022” ofrojnë një përshkrim të sistemit të pensioneve dhe aseteve të tyre në vendet e OECD-së dhe në një përzgjedhje juridiksionesh nga vende jo anëtare të OECD-së, në vitin 2022. Të dhënat paraprake për vitin 2022 tregojnë se vlera e aseteve të destinuara për dalje në pension ka rënë me rreth 16% në shumicën e vendeve të OECD. Normat negative të kthimit të investimeve shpjegojnë pjesën më të madhe të rënies së aseteve të pensioneve:

- Instrumentet me të ardhura fikse, klasa më e madhe e aktiveve për ofruesit e pensioneve, kanë parë rënie të mëdha në vlerësimet në të gjithë globin e nxitur nga inflacioni i lartë dhe normat e interesit;
- Uljet e përhapura në vlerësimet e kapitalit kanë përkeqësuar kthimet negative në disa tregje.

HUNGARI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga portali informativ i lajmeve portfolio.hu të cilit i referohet Xprimm, si pasojë e stuhive të ndodhura gjatë javës së parë të gushtit, deri më tani janë pranuar rreth 20 mijë dëme të lidhura me kontratat e sigurimit të banesave nga kompanitë e sigurimit që kishin dërguar të dhënat e tyre në Shoqatën e Siguruesve Hungarez, MABISZ. Më tej ky numër pritet të rritet në ditët në vijim.

Shoqata e Siguruesve Hungarezë vlerëson që sektori mund të llogarisë shlyerjen e kërkesave për shuma rekord, madje që mund të tejkalojnë 4.5 miliardë HUF ose rreth 11.76 milionë euro. Shoqata MABISZ ka informacione mbi pagesat e dëmeve për sezonin e stuhive maj-gusht që nga viti 2010. Vitin e kaluar, kjo shifër arriti në 7.5 miliardë HUF në katër muaj, ndërsa në 2018, e gjithë "kostoja" e sezonit të stuhive ishte më pak se 3.2 miliardë HUF.

Aktualisht, 73-74% e pronave rezidenciale në Hungari kanë sigurim shtëpie, por një pjesë e konsiderueshme e kontratave ekzistuese janë lidhur disa vite më parë dhe nuk janë përditësuar që atëherë, në përputhje me situatën aktuale të pronës, zgjerimin, apo modernizimin e mundshëm të saj.

MAQEDONIA E VERIUT

www.xprimm.com

Sipas të dhënave tremujore të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Maqedoninë e Veriut, në fund të marsit 2023, tregu i sigurimeve në vend arriti në 3.5 miliardë denarë ose rreth 57 milionë euro, me një rritje prej 17.8% në terma vjetorë.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto për sektorin e sigurimeve të Jo-Jetës u rrit për 19.6% në terma vjetorë, duke arritur në 3 miliardë denarë. Kjo shifër zë afërsisht 84.7% të vëllimit total të primeve të shkruara bruto. Në setorin e sigurimit të Jetës, vëllimi i primeve të shkruara bruto arriti në 538 milionë denarë, ose rreth 9% më shumë në terma vjetorë.

Një shoqëri e re sigurimesh në Maqedoninë e Veriut

Sipas informacioneve të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, të Maqedonisë së Veriut, ISA, pas një pauze prej gjashtë vitesh në tregun e sigurimeve të Jetës në vend është themeluar kompania e re e sigurimeve, në të cilën pronarët sllovenë investojnë 4 milionë euro.

ISA dha licencën për të operuar një kompani të re sigurimesh Prva Zivot. Kompania do të ofrojë shërbime të sigurimit të Jetës. Themeluesi dhe pronari i vetëm i kompanisë së sapokrijuar të sigurimit të Jetës është Holdingu slloven i sigurimeve PRVA GROUP, i cili ka dy dekada që menaxhon fondet e pensione në Slloveni, Serbi, Maqedoni e Veriut dhe Kosovë. Grupi ka një kompani sigurimesh në Slloveni, dhe hyrja e tyre në tregun e sigurimeve të Maqedonisë së Veriut pritet të përmirësojë konkurrencën dhe të kontribuojë në pasurimin e ofertës së produkteve të sigurimit të Jetës.

Grupi investoi 4 milionë euro në kompaninë e sapokrijuar të sigurimeve, që është shuma e kapitalit themelues të Prva Zivot.

Prva Zivot do të fillojë nga puna brenda gjashtë muajve nga dita e dhënies së licencës, dhe selia e kompanisë do të jetë në Shkup. Kjo do të jetë kompania e gjashtë në tregun maqedonas të sigurimeve të Jetës, ku aktualisht operojnë sigurimet Croatia - Zivot, Triglav zivot, Grawe, Winner Life VIG dhe Uniqa Life.

POLONI

www.xprimm.com

Në korrik, çmimi mesatar i policës së sigurimit MTPL për pronarët e mjeteve motorike ishte 518 PLN ose rreth 117.46 euro, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2022 ishte 497 PLN. Ky tregues do të thotë se primi aktual është 4.9% më i lartë se një vit më parë. Informacioni i referohet shkrimit në Gazeta Ubezpieczeniowa, dhe bazohet në raportin e sigurimit të RMF FM dhe Rankomat.

Një ekspert i sigurimit motorik të Rankomat, i cituar nga media, beson se rritje e mëtejshme e çmimit mund të ndodhë së shpejti. Një nga arsyt është se vlera mesatare e dëmit u rrit shumë. Ky informacion bazohet në të dhënat e Dhomës së Sigurimeve të Polonisë, sipas së cilës vlera mesatare e dëmit aktualisht është 8,800 PLN, që është 15% më shumë se një vit më parë.

SERBI

www.xprimm.com

Sipas statistikave të fundit të publikuara nga Banka Kombëtare e Serbisë, NBS, siguruesit në vend e mbyllën tremujorin e parë 2023 me një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 35.9 miliardë RSD ose rreth 306 milionë euro. Kjo shifër është 13.95% më shumë në krahasim me vitin e kaluar.

Në të njëjtën kohë, pagesat e dëmeve nga shoqëritë e sigurimeve u rritën me 11.93% në terma vjetore duke arritur në 15.9 miliardë dollarë, të ndikuara kryesisht nga rritjet dyshifrore të raportuara te pothuajse të gjitha nënklasat e sigurimeve.

SLOVAKIA

www.xprimm.com

Sipas shifrave të tremujorit të parë 2023, të publikuara nga Banka Kombëtare e Sllovakisë, tregu i sigurimeve në vend arriti në 579.23 milionë euro në fund të marsit 2023 me një rritje prej 14% në terma vjetore. Ndërsa dëmet bruto të paguara nga siguruesit ishin në vlerë rreth 220.62 milionë euro, duke shënuar një rënie me 13.6% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto për siguruesit e Jetës u rrit me 26.74% duke arritur në 245.87 milionë euro. Një ndikim të madh në këtë rritje kishte norma e rritjes prej 62% e raportuar për produktet e lidhura me skemat e investimeve. Për klasat e sigurimeve të Jo-Jetës, primet e shkruara bruto arritën në 333.36 milionë euro, me rritje prej 6.12% më shumë se një vit më parë.

SLLOVENIA

www.xprimm.com

Sipas shifrave tremujore të Shoqatës Sllovene të Sigurimeve, tregu vendas i sigurimeve arriti në 825.3 miliardë euro në fund të marsit 2023, duke pasur një rritje prej 8.3% krahasuar me një vit më parë. Vëllimi i primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jetës shënoi një normë negative me rënie prej -0.2% në vit duke arritur në 197.3 milionë euro. Ndërsa segmenti i sigurimit të përgjithshëm u rrit me 11.2% në vit duke arritur në 628 milionë euro, me një rënie prej - 76.1% të primeve të shkruara bruto totale.

Sa i përket dëmeve të paguara, vlera e përgjithshme ishte 506 milionë euro, nga të cilat rreth 141.6 milionë euro dëmshpërblime të Jetës, 172 milionë euro pagesa për kontratat e sigurimit shëndetësor, 122 milionë euro pagesa për sigurimet motorike (MTPL dhe sigurimin Kasko së bashku) dhe rreth 35.5 milionë euro për sigurimet e pronës.



Për informacion të mëtejshëm
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al